

UNITED NATIONS
United Nations Interim
Administration Mission
in Kosovo



NATIONS UNIES
Mission d'Administration
Intérimaire des Nations
Unies au Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

Kryesia e Kuvendit
Mbledhja nr. 02-75/25-07
Prishtinë, më 11 tetor 2007, në orën 13:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

i mbledhjes së Kryesisë së Kuvendit të Kosovës me kryetarët e grupeve parlamentare,
të mbajtur më 11 tetor 2007

Në mbledhje morën pjesë: Kolë Berisha, kryetar i Kuvendit dhe anëtarët e Kryesisë:
Sabri Hamiti, Xhavit Haliti, Naim Maloku, Gazmend Muhaxheri dhe Bislim Hoti, kurse
mungo (me arsye) Ramë Buja.

Nga grupet parlamentare: Alush Gashi, Gjylnaze Sylja, Teuta Sahatqija, Ramadan
Kelmendi dhe Gjergj Dedaj.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Sali Rexhepi dhe Sherif
Konjufca;

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Skënder Durmishi dhe But Dedaj;

Nga ZKM-ja: Shefik Kurtishi;

Nga Projekti për Mbështetje të Mëtejme Kuvendit: Hugues Courtivron dhe

Nga OSBE-ja: Floriana Shala.

Mbledhjen e kryesoi **Kolë Berisha**, kryetar i Kuvendit të Kosovës.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit për rendin e ditës dhe për materialet e shpërndara për këtë mbledhje.

Ai propozoi që rendit të ditës t'i shtohen edhe shtatë pika. Kryesia miratoi propozimin e kryetarit.

Kryesia i zhvilloi punimet me këtë

R E N D I T E

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë të 25 shtatorit 2007;
2. Propozimi i rendit të ditës për seancën plenare të radhës;
3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe i kërkesave dhe
4. Të ndryshme.

Në fillim të mbledhjes, **kryetari** i informoi anëtarët e Kryesisë dhe kryetarët e grupeve parlamentare me materialet e përgatitura për shqyrtim në seancën plenare të radhës dhe kërkoi pëlqimin e tyre për secilën pikë të rendit të ditës.

Alush Gashi, kryetar i Grupit Parlamentar të LDK-së, propozoi që në Kuvend deri në fund të kësaj legjislature të mos ketë pyetje parlamentare dhe interpelanca, me arsyetimin se ato po marrin kahje të fushatës zgjedhore.

Kryesia nuk e miratoi propozimin e cekur më lart.

Gjylnaze Sylja, kryetare e Grupit Parlamentar të AAK-së, paraqiti mocion që Kuvendi të marrë vendim për t'iu shmangur rregullës 63 të Rregullues së Punës.

Kryesia nuk e miratoi propozimin e cekur më lart.

Kryetarët e grupeve parlamentare (të pranishëm në mbledhje) u pajtuan me propozimin e pikave të rendit të ditës për seancën e radhës, si dhe për datën e mbajtjes së saj më **18 tetor 2007**.

Pas kësaj kohe, Kryesia i zhvilloi punimet pa praninë e kryetarëve të grupeve parlamentare.

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë të 25 shtatorit 2007

Procesverbali i mbledhjes së Kryesisë të 25 shtatorit 2007 u miratua pa vërejtje.

2. Propozimi i rendit të ditës për seancën plenare të radhës

Kryesia, pasi i shqyrtoi përgatitjet e nevojshme për secilën pikë, veç e veç, vendosi që Kuvendit t'ia propozojë rendin e ditës për seancën plenare më **18 tetor 2007**, si vijon:

1. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare me 27 shtator 2007,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për mbrojtjen e mjedisit,
4. Vazhdimi i procedimit të amendamenteve në Rregulloren e Punës të Kuvendit,
5. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Telekomunikacion lidhur vërejtjet e UNMIK-ut në Ligjin për sigurinë në komunikacionin rrugor,
6. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Shërbime Publike lidhur me vërejtjet e UNMIK-ut në Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për kadastër.

3. Shqyrtimi i rekomandimeve:

- 3.1 Shqyrtimi i kërkesës së Komisionit për Siguri lidhur me vërejtjet e UNMIK-ut në Ligjin për emrin personal dhe në Ligjin për numrin personal

Naim Maloku, në emër të Komisionit FunkSIONAL, i informoi anëtarët e Kryesisë lidhur me vërejtjet e UNMIK-ut në Ligjin për emrin personal dhe në Ligjin për numrin personal, që kishin të bënim më tepër me përkthimin joadekuat të tyre në gjuhën angleze.

Kryesia, pasi i shqyrtoi vërejtjet e UNMIK-ut për dy ligjet e cekura më lart, nxori këtë

P Ë R F U N D I M

Administrata e Kuvendit duhet ta angazhojë përkthyes të licencuar të gjuhës angleze për të rishikuar përkthimin anglisht të Ligjit për emrin personal dhe të Ligjit për numrin personal dhe t'i riprocedohen PPSP-së, për shpallje.

- 3.2 Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion lidhur me Projektin për ndërtimin e autostradës Morinë – Merdar.

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me Rekomandimin e Komisionit të cekur më lart, vendosi që këtë çështje ta shtyjë për më vonë.

- 3.3 Shqyrtimi i Raportit të Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për transportin e mallrave të rrezikshme.

Kryesia vendosi që shqyrtimi i Raportit të Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për transportin e mallrave të rrezikshme të shtyhet për më vonë.

3.4 Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor lidhur me ndërtimet ilegale nga ana e Qeverisë së Serbisë në Veriun e Mitrovicës

Kryesia vendosi që shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor lidhur me ndërtimet ilegale nga ana e Qeverisë së Serbisë në Veriun e Mitrovicës të shtyhet për më vonë.

3.5 Shqyrtimi i kërkesës së Grupit Parlamentar për Integrim për ta ftuar në Interpelancë ministrin e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë, Agim Veliu

Kryesia, me kërkesë të Xhavit Halitit dhe me pëlqimin e përfaqësuesit të Grupit Parlamentar për Integrim, kërkesa për ta ftuar në Interpelancë ministrin e Arsimit, Agim Veliu, u shty për më vonë.

3.6 Shqyrtimi i kërkesës së Komisionit për Buxhet edhe Financa lidhur me iniciimin e procedurës për zgjedhjen e Organit Shqyrtues të Prokurimit

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me kërkesën e Komisionit për Buxhet edhe Financa, vendosi që iniciimi i procedurës për zgjedhjen e Organit Shqyrtues të Prokurimit të merret më vonë.

3.7 Shqyrtimi i kërkesës së Gazmend Muhaxheri, anëtar i Kryesisë të Kuvendit, për hartimin e Rregullores për të drejtat dhe përgjegjësitë e stafit politik të Kuvendit

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e Gazmend Muhaxheri, nxori këtë

P Ë R F U N D I M

1. Mbështetet kërkesa e Gazmend Muhaxheri, anëtar i Kryesisë së Kuvendit, për hartimin e Projekt-Rregullores për të drejtat dhe përgjegjësitë e stafit politik të Kuvendit.
 2. Ngarkohet Sekretari i Kuvendit, që në bashkëpunim me Konzorciumin e parlamenteve që e mbështesin Kuvendin e Kosovës, ta hartojnë Projekt-Rregulloren dhe t'ia paraqesin Kryesisë për miratim.
- 3.8 Shqyrtimi i kërkesës së Gazmend Muhaxheri, anëtar i Kryesisë të Kuvendit, për lirimimin e zyrave të ndërtesës së Kuvendit nga ana e Ministrisë së Transportit dhe Telekomunikacionit dhe nga ana e personelit të shtyllës së IV -të të UNMIK-ut

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e Gazmend Muhaxheri, nxori këtë

P Ë R F U N D I M

1. Mbështetet kërkesa e Gazmend Muhaxherit, anëtar i Kryesisë së Kuvendit, për lirim të ndërtesës së Kuvendit nga ana e Ministrisë së Transportit dhe e Postë-Telekomunikacionit, nga Ministria e Drejtësisë dhe nga personeli i shtyllës IV të UNMIK-ut.
2. Ngarkohet Sekretari i Kuvendit, Ismet Krasniqi, t'i ndërmarrë të gjitha veprimet administrative që ndërtesa e Kuvendit të jetë në funksion të deputetëve të Kuvendit dhe të stafit të Administratës së saj.

3.9 Shqyrtimi i Udhëzimit Administrativ për hartimin dhe publikimin e procesverbaleve dhe të transkripteve të organeve të Kuvendit të Kosovës

Kryesia, pasi e shqyrtoi Propozim -Udhëzimin Administrativ, mori këtë

V E N D I M

Miratohet Udhëzimi Administrativ për hartimin dhe publikimin e procesverbaleve dhe të transkripteve të organeve të Kuvendit të Kosovës.

4. Të ndryshme:

4.1 Shqyrtimi i kërkesave për kompensimin e mëditjeve

Kryesia, pasi i shqyrtoi kërkesat e parashtruara për kompensimin e mëditjeve, mori këtë

V E N D I M

Kryesia nuk i miratoi kërkesat e anëtarëve të Komisionit për Bujqësi, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor për kompensimin e mëditjeve gjatë qëndrimit të tyre njëditor në Maqedoni; Të deputetit Agim Krasniqi për pjesëmarrjen e tij në Grupin e Punës për hartimin e Ligjit për siguri private dhe të deputetes Fatmire Mulhaxha-Kollçaku për vizitë në Kroaci.

4.2 Njoftimi i Grupit Parlamentar për Integrim lidhur me ndërrimin e kryetarit të këtij grupi

Kryesia u informua se kryetar i Grupit Parlamentar për Integrim për periudhën tremujore do të jetë Gjergj Dedaj.

4.3 Njoftimi me shkresën e kryetarit të Komisionit për Mbrojtjen e Interesave të Komuniteteve dhe për Kthim

Bislim Hoti, anëtar i Kryesisë dhe njëherësh edhe anëtar i Komisionit për Mbrojtjen e Interesave të Komuniteteve dhe për Kthim, i informoi anëtarët e Kryesisë se kryetari i këtij komisioni, Rangjel Nojkiq, shkresën e ka bërë në emrin e tij personal dhe të partisë

së tij. Ai në atë shkresë nuk i ka paraqitur qëndrimet e Komisionit për Mbrojtjen e Interesave të Komuniteteve dhe për Kthim.

4.4 Kryesia u informua për mbajtjen e Konferencës Rajonale për Çështje të Mjedisit në Prishtinë; Për kërkesën e Agjencisë kundër korrupsionit; Me ftesën për pjesëmarrjen në Konferencën Rajonale në Tiranë; Për procedimin e Projektligjit për hetim parlamentar dhe për procedimin e Rregullores së Punës të Kryesisë.

4.5 Informata lidhur me procedimin e dy tenderëve të fundit

Kryetari i informoi në hollësi anëtarët e Kryesisë lidhur me procedimin e Tenderit për pajisje me kompjuterë dhe UPS dhe të Tenderit për rinovim e kulmit të ndërtesës së Kuvendit.

Në bazë të informatave, që kam pasur, për parregullsitë gjatë procedimit me dy tenderët e cekur më lart, kam kërkuar nga sekretari i Kuvendit të ndërmarrë masa të përkohshme kundër udhëheqësit të Divizionit të prokurimit dhe ndaj të njëjtit të iniciojë procedurën disiplinore, si dhe të hapë procedurë disiplinore kundër atyre personave që janë të implikuar në këtë proces.

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me procedimin e hapjes dhe të vlerësimit të Tenderit për pajisje me kompjuterë dhe UPS dhe të Tenderit për rinovim e kulmit të ndërtesës së Kuvendit, nxori këtë

P Ë R F U N D I M

Kërkohet nga Sekretari i Kuvendit t'i ndërmarrë të gjitha veprimet procedurale dhe disiplinore për të saktësuar përgjegjësinë, si dhe marrjen e masave kundër shkelësve të procedurave lidhur me Tenderin për pajisje me kompjuterë dhe UPS dhe Tenderin për rinovim e kulmit të ndërtesës së Kuvendit.

Kryetari e deklaroi mbledhjen të mbyllur në orën 15 : 00.

E hartoi:
Divizioni i Çështjeve Plenare e Procedurale

Kryetari i Kuvendit të Kosovës
Kolë BERISHA
